

We make your dreams come true
EPHESUS
Agjencioni Turistik Travel Agency



ISTANBUL
210€
Cmimi përfshinë: 4 nete në hotelin me 4*, biletën e aeroplanit, transferin aeroport - hotel - aeroport



SHOPPING SELANIK
Hotel Capsis 4* 95€
Holiday Inn 5* 115€

Cmimi përfshinë 2 nete në hotelin e perzgjedhur me mengjes, transportin dhe shopping tour



SKIJIME BANSKO
Balkan Jewel 4* 145€
Florimont Casino 4* 170€
Hotel Emerald 4* 195€
Hotel Rilski 4* 205€
Hotel Lion 4* 210€
Hotel Sport 4* 210€



TOP OFERTE
7 NETË NË HOTEL STRAJITE 4*
Cmimi përfshinë, hotelin me mengjes dhe darke, ski pasin, mesuesin, skijat dhe transferin deri në ski lift

VITI RI 2012 ISTANBUL

HAMIDIYE 4* 249.00€
BARON 4* 280.00€
SANTA PERA 4* 285.00€
MARBLE 4* 310.00€
GRAND HALIC 4* 320.00€
GOLDEN AGE I 4* 335.00€



TOP OFERTE ANTALYA
3 nete në ANTALYA me pritjen e vitit të ri duke filluar nga

329€
TOP OFERTE

038 610 331 / 610 233
info@ephesus-travel.net
www.ephesus-travel.net

DEBATOHEN KUOTA GJINORE DHE PËRFAQËSIMI I BARABARTË POLITIK I GRAVE NË KOSOVË

Kosovaret duan përfaqësim 50 me 50 në vendimmarrje

Drude Dahlerup, profesoreshë në Universitetin e Stokholmit dhe njohëse e çështjeve dhe e kuotave gjinore, nuk e preferon heqjen e kuotave për Kosovën. Heqja e saj ndoshta mund të bëhet me kalimin e viteve, thotë ajo

Blerta Aliu

PRISHTINË, 12 DHJETOR – Shoqëria civile së bashku me ekspertë për çështje të kuotës gjinore janë shprehur të hënën kundër heqjes së kuotës gjinore nga Ligji për zgjedhjet. Ata madje kanë propozuar ngritje të saj në nivelin 50 me 50 për të dyja gjinitë në Kosovë. Gjatë një debati të organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) lidhur me përfaqësimin e barabartë politik për gratë në Kosovë, u propozuan disa alternativa për ndryshimin e kuotës gjinore.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, vlerësoi se roli i gruas në vendimmarrje duhet të rritet.

“Kuvendi i Kosovës për të përmirësuar barazinë gjinore dhe përfaqësimin e grave në organin më të lartë legjislativ e përfaqësues, si veprim afirmativ, caktoi një kuotë prej 30 për qind të pjesëmarrjes së femrave në Kuvend”, tha Krasniqi.

Sipas kryeparlamentarit Krasniqi, barazia gjinore nuk është një dhu-ratë që u jepet grave nga burrat apo institucionet, ajo përbën të drejtën e ligjshme dhe natyrore të tyre.

“Nuk mund të flasim për kurrfarë procesi të demokratizimit të Kosovës

dhe të institucioneve të saj, pa pasur parasysh kriteret e barazisë së gruas me burrin në shoqëri. Gruaja në Kosovë i ka kontribuar emancipimit, zhvillimit dhe lirisë së shoqërisë sonë, prandaj ia ka siguruar vetes statusin e të barabartit në të”, ka thënë Krasniqi, duke inkurajuar shoqërinë civile për ta vazhduar kontributin në çështjet gjinore.

Drude Dahlerup, profesoreshë në Universitetin e Stokholmit dhe njohëse e çështjeve dhe e kuotave gjinore, nuk e preferon heqjen e kuotave për Kosovën. Shumë vende të tjera, sipas saj, janë duke e futur këtë kuotë dhe heqja e saj ndoshta mund të bëhet me kalimin e disa viteve. Sipas Dahlerupit, po të hiqet tani kjo kuotë, për Kosovën do të jetë një katastrofë. “Kosova është një rast i mirë sa i përket sistemit të kuotave. Ka një sistem të veçantë që është gati më i miri në botë. Mund ta rregulloni çështjen e kuotave, por assesit s’duhet ta hiqni atë, ngase shumica në vendimmarrje janë meshkuj dhe duhet patjetër të afirmohen gratë”, ka thënë Dahlerup.

Sistemi me kuota, sipas Dahlerupit, është një trend botëror dhe gratë që janë të kualifikuara kërkohen nga partitë. Ajo rekomandoi për Kosovën sistemin zinxhiror,



Shoqëria civile dhe ekspertët për çështje të kuotës gjinore janë shprehur kundër heqjes së kuotës gjinore nga Ligji për zgjedhjet. Ata madje kanë propozuar kuotë 50 me 50 për të dyja gjinitë

që nënkupton përfaqësim 50 me 50 të femrave dhe meshkujve dhe renditjen e tyre në kuvend sipas radhës, një femër, një mashkull.

Dahlerup tha se janë 102 shtete në botë të cilat i kanë të vendosura kuotat gjinore. Prej tyre janë 52 vende, të cilat i kanë të vendosura me ligj, ndërsa 50 vendet e tjera i kanë të vendosura në bazë vullnetare nga partitë politike.

Luljeta Vuniqi, drejtoreshë në Qen-

drën Kosovare për Studime Gjinore, tha se është diskutuar mjaft shumë për çështje të kuotës dhe se tani është koha për strategji lidhur me të. “Partitë politike nuk kanë strategji për rritjen e kuotave, ndërkaq forumet e grave në kuadër të partive janë modele të tejkaluara. Në këtë formë po marginalizohen gratë dhe zëri i tyre nuk po dëgjohet. Pozita e grave nëpër parti politike nuk është e mirë”, ka thënë Vuniqi.

AMBASADORI I KOSOVËS NË GJERMANI TAKON ISH-KANCELARIN HISTORIK, HELMUT KOHL

Kohl vlerëson lirinë e Kosovës, i mungon Evropa e bashkuar

Në takim, kancelari Kohl shprehu dëshirën e tij për të vizituar Kosovën, derisa ambasadori Mirdita ia dhuroi atij një shtatore të Nënës Terezë dhe një hartë të Kosovës me mineralet nga nëntoka e saj e pasur

BERLIN, DHJETOR – Ambasadori i Kosovës në Gjermani, Vilson Mirdita, ka vizituar, javën e shkuar, kancelarin historik të Gjermanisë, Helmut Kohl, në rezidencën e tij në Ludwigshafen.

Në bisedën me ambasadorin e Kosovës, kancelari Kohl i vlerësoi lart përpjekjet e popullit të Kosovës për të qenë i lirë dhe për të ndërtuar shtetin e vet demokratik, por ai në të njëjtën kohë vuri në dukje edhe mungesën e vizionit për të përfunduar, siç tha, projektin e Evropës së bashkuar, ku vendet e Ballkanit Perëndimor doemos do të ishin brenda saj qëkur, sepse ato aty e kanë vendin.

Ambasadori Mirdita e informoi gjerësisht kancelarin Kohl për arritjet, por edhe për sfidat me të cilat ballafaqohen populli dhe shteti i Kosovës, ndërsa njëra nga temat e bisedës ishte edhe arsimimi i gjeneratës së re.

Puna e gjimnazit “Loyola” në

Prizren u vlerësua si një shembull i bashkëpunimit të mirëfilltë gjermano-kosovar, një projekt i realizuar me sukses në këtë fushë kaq të rëndësishme për të ardhmen e vendit tonë.

Kancelari Kohl shprehu dëshirën e tij për të vizituar Kosovën, derisa ambasadori Mirdita ia dhuroi atij një shtatore të Nënës Terezë dhe një hartë të Kosovës me mineralet nga nëntoka e saj e pasur.

“Një popull që i ka dhënë botës një personalitet të tillë si Nëna Terezë, me të cilën jam takuar edhe personalisht, pa dyshim që ka një perspektivë të ndritshme”, tha me këtë rast kancelari Kohl.

Në takimin që zgjati rreth dy orë ishte prezent edhe deputeti i CDU-së në Bundestag, z. Philip Missfelder, i cili në fraksionin e partisë së tij qeveritare e mban postin e zëdhënësit për politikë të jashtme.

Xhevat Ukshini



Ambasadori i Kosovës Vilson Mirdita në takim me kancelarin Helmut Kohl

Gjatë periudhës qershor-nëntor, kallëzim penal ndaj 42 policëve



Me qëllim të promovimit të punës së Inspektoratit Policor të Kosovës ka nisur një fushatë, e cila ka për qëllim adresimin më të lehtë të qytetarëve ndaj sjelljeve jo të mira të pjesëtarëve të policisë

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Numri i policëve të implikuar në shkeljet e ndryshme vetëm brenda periudhës qershor-nëntor ka rezultuar me procedimin e 113 rasteve për vepra penale, 42 për kallëzime penale dhe 8 aktakuza për punonjës policorë.

E me qëllim të promovimit të punës së Inspektoratit Policor të Kosovës ka nisur një fushatë, e cila ka për qëllim adresimin më të lehtë të qytetarëve ndaj sjelljeve jo të mira të pjesëtarëve të policisë.

Zv.ministri Sasha Rashiq ka thënë se qëllimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme është krijimi i një shoqërie multietnike,

demokratike dhe të lirë në Kosovë, ku të gjithë do të ndihen të sigurt. Mbështetje në punën e Inspektoratit ka dhënë edhe shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Werner Althofer.

Ndërsa shefi ekzekutiv i IPK-së, Fitim Shishani, theksoi se Inspektorati i Policisë si institucion i pavarur në kuadër të MPB-së ka qëllim thelbësor luftën kundër krimit të organizuar brenda policisë dhe të krijojë një polici të përgjegjshme, e cila do të siguronte respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut sipas Kushtetutës. (koha.net)